



UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan Republika e
Kosovës ëëë.uni-gjiilan.net
tel: 0280390112

**RAPORT PËRMBLEDHËS ME RASTIN E Ç’REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE
2022/2023**

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	3
Metodologjia e hulumtimit.....	3
2.1 Qëllimi i Hulumtimit.....	3
2. Metodatat e hulumtimit	3
3.Rezultatet e Hulumtimit.....	4
3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit	4
3.2 Analiza e pyësorëve	4
4. Rekomandime	6

Hyrje

Në rritje është tendenca e studentëve për të braktisur universitetet për shkaqe të ndryshme. Disa prej tyre e lënë studimin për shkak të sfidave financiare, duke hasur vështirësi të shpenzimeve të lidhura me jetesën studentore. Të tjerë mund të ndiejnë mungesën e motivimit apo tërheqje për fushën e tyre të studimit, duke e gjetur veten në një rrugë të caktuar shkollimi që nuk përputhet me pasionin apo interesin e tyre të vërtetë. Disa faktorë tjerë, si stresi akademik, problemet personale, ose mungesa e mbështetjes sociale, gjithashtu mund të ndikojnë në vendimin e tyre për të braktisur universitetin. Kjo tendencë kërkon përgjigje të ndërgjegjshme nga institucionet arsimore dhe komuniteti në përgjithësi për të ndihmuar në adresimin e sfidave që i shtyjnë studentët drejt këtij vendimi të vështirë.

Këshilli për Mbikëqyrje, Cilësi dhe Vlerësim i Universitetit “Kadri Zeka“ në Gjilan, ka vendosur që të bëhet një vlerësim për studentët të cilët braktisin studimet në këtë Universitetin Kadri Zeka, Pyetëtori është hartuar nga ZzhAC më pas është vendosur në platformën SMU, ku studentët përpara së të tërheqin dokumentet nga Universiteti janë të obliguar që të plotësojnë këtë Pyetësor.

Metodologjia e hulumtimit

2.1 Qëllimi i Hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë përvojës së studentëve në UKZ.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat përcaktojnë numrin e studentëve që i ndërpresin studimet.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t’u shërbejnë Universitetit për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit.

2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Në kuadër të kësaj kemi plasuar pyetësin në platformën SMU, në momentin që studenti vendos që ta bëjë ç’regjistrimin, është i detyrueshëm ta plotësojë pyetësin.

3.Rezultatet e Hulumtimit

3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit

Në kuadër të punëve të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (ZZHA) dhe në bashkëpunim me Menaxhmentin e lartë është paraparë që përveç vlerësimeve të rregullta të cilat janë planifikuar të realizohen në UKZ, të hulumtohen edhe shkaqet e braktisjes së studimeve nga ana e studentëve. Lidhur me këtë ka hartuar një pyetësor i cili përmban 5 pyetje gjithsej të cilat kanë të bëjnë me vitet e studimit, fakulteti ku ka ndjekur studenti studimet, kënaqësia e studentëve me cilësinë e studimeve, kushtet ekonomike të familjes prej nga vjen studenti si dhe arsyet e braktisjes së studimeve. Secila pyetje ka pasur tre deri në pesë alternativa të përgjigjes.

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit si dhe publikimin ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në konsultim me KMCV-në

3.2 Analiza e pyetësorëve

3.2.1 Rezultatet me rastin e ç' regjistrimit të studentëve nga UKZ.

POHIMET		Vlera Mesatare	
		Opsioni	Hera e përgjigjes
1	Qe sa vite jeni student i UKZ-së ?	1 vit	44
		3 vite	79
		5 vite e më shumë	84
2	Në cilin Fakultet keni ndjekur studimet deri tani?	Fakulteti Ekonomik	84
		Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	17
		Fakulteti i Edukimit	29
		Fakulteti Juridik	77
		Fakulteti i Shkencave Aplikative	0
3	Sa jeni të kënaqur me cilësinë e studimeve në UKZ?	Shumë të kënaqur	77
		Të kënaqur	106
		Aspak të kënaqur	24
4	Cilat janë kushtet ekonomike të familjes tuaj?	Shumë të mira	70
		Mesatare	130
		Jo të mira	7
5	Cilat janë arsyet për ndërprerjen e studimeve?	Cilësia e Studimeve	28
		Kushtet ekonomike	6
		Ikja jashtë vendit	44
		Arsye tjetër	129

Tabela 1. Rezultatet e studenteve që braktisen UKZ

Në lidhje me periudhën e studimeve të studentëve në UKZ, 44 studentë pas 1 viti kanë braktisur studimet, 79 studentë pas 3 vite janë ç’regjistruar nga Universiteti, ndërsa 84 studentë kanë qenë studentë për 5 vite ose më shumë.

Për sa i përket Fakultetit të cilit kanë qenë pjesë; 84 studentë kanë ndjekur studimet në Fakultetin Ekonomik, 17 studentë kanë qenë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, 29 studentë kanë studiuar në Fakultetin e Edukimit, 77 studentë kanë qenë në Fakultetin Juridik, asnjë nga Fakultetin e Shkencave Aplikative.

Se sa studentët janë të kënaqur me cilësinë e studimeve në UKZ, sipas të dhënave 77 prej tyre janë shumë të kënaqur, 106 studentë shprehen të kënaqur dhe 24 studentë deklarohen se nuk janë fare të kënaqur.

Në lidhje me kushtet ekonomike të familjes së tyre të dhënat tregojnë se 70 studentë kanë kushte ekonomike shumë të mira, 130 studentë kanë kushte ekonomike mesatare kurse 7 prej tyre janë shprehur se kanë kushte ekonomike jo të mira.

Sipas të dhënave shohim se arsyeja e ndërprerjes së studimeve në UKZ është e ndryshme: 28 studentë kanë ndërprerë studimet për shkak të cilësisë së dobët të studimeve, 6 studentë kanë ndërprerë për shkak të kushteve ekonomike, 44 studentë kanë ndërprerë për ikje jashtë vendit, 129 studentë kanë përmendur arsye të tjera për ndërprerjen e studimeve.

Këto të dhëna tregojnë një gamë të gjerë të përvojave dhe arsyetimit të studentëve në lidhje me studimet në UKZ, duke theksuar disa sfida të ndryshme që ata mund të kenë përballur gjatë kohës së tyre si studentë, megjithatë një numër i madh i studentëve nuk shprehen për ndonjë arsye të veçantë.

4. Përfundime dhe Rekomandime

Bazuar në të dhënat e prezantuara, disa rekomandime mund të jepen për të adresuar disa nga sfidat apo problematikat që studentët mund të kenë hasur:

Cilësia e Studimeve:

Institucioni mund të përmirësojë cilësinë e ofrimit të studimeve duke investuar në trajnimin e pedagogëve, duke përdorur metoda më të përshtatshme të mësimdhënies dhe duke siguruar burime shtesë për ndihmë akademike për studentët.

Kushtet Ekonomike:

Mund të krijohen programe mbështetëse për studentët me kushte ekonomike të vështira, duke ofruar bursa, kredite ose ndihma për punësim brenda universitetit për të ndihmuar në pagesat e semestrit apo në nevojat e tyre të përditshme.

Ndërprerja për Ikje Jashtë Vendit:

Universiteti mund të krijojë programe shkëmbimi studentor ose programe studimi jashtë vendit që janë më të lehta për qasje, duke inkurajuar eksperiencat e studimit në nivel ndërkombëtar për të pasur një perspektivë më të gjerë dhe për të krijuar mundësi të reja për studentët.

Përmirësimi i Ndjenjës së Kënaqësisë së Studentëve:

Për të adresuar shqetësimet e studentëve lidhur me cilësinë e studimeve apo kushtet ekonomike, mund të organizohen anketime apo sondazhe rregullore për të mbledhur më shumë vlerësime dhe sugjerime nga studentët për të përmirësuar përvojën e tyre universitare.

Përgatitja e Rrjetit të Mbështetjes:

Universiteti mund të zgjerojë rrjetin e mbështetjes për studentët, duke ofruar këshillim akademik, këshillim karriere, dhe shërbime të tjera që mund të ndihmojnë në menaxhimin e stresit akademik apo sfidave personale që mund të ndikojnë në performancën e tyre shkollore.

Këto rekomandime mund të ndihmojnë në adresimin e disa nga sfidat që studentët mund të kenë përballur gjatë studimeve të tyre në UKZ dhe mund të ndihmojnë në përmirësimin e përvojës së tyre universitare.